



**REPUBLIKA E KOSOVES**  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
OSNOVNI SUD PRISTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

---

**AD/GJTHPR/22/24**

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga E.B në cilësinë e palës së dëmtuar ndaj gjyqtarit A.K, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 08.10.2024 nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e ushtruar nga E.B në cilësinë e palës së dëmtuar ndaj gjyqtarit A.K për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

**A r s y e t i m**

Me datë 09.09.2024 përmes parashtresës së drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në cilësinë e palës së dëmtuar E.B ka paraqitur kërkesë për inicim të procedurës disiplinore për gjyqtarin A.K për shkak të pretendimeve për shkelje disiplinore. Ndërsa me datë 19.09.2024 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, çështjen e ka adresuar tek Organi Kompetent, Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë për vendosje të mëtutjeshme, kjo në harmoni me nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Parashtruesi i ankesës në shkresën e tij ka deklaruar se: gjyqtari A.K ka nxjerrë aktgjykimin me urdhër ndëshkimor P.nr. 3729/21 të datës: 03.03.2023, mirëpo sipas tij asnjëherë nuk është thirrur në seancë gjyqësore lidhur me këtë rast.

Tuje ka deklaruar se i akuzuari në këtë çështje gjyqësore M.C e ka kërcënuar dhe ka tentuar që të vras, dhe për këtë e ka lajmëruar edhe policinë, dhe për këtë e ndihmon edhe një prokuror nga Dragashi i Prizrenit. Andaj mbi të lartcekurat, ka pretenduar se gjyqtari A.K i kishte bërë shumë shkelje.

Në lidhje me pretendimet e parashtruara, gjyqtari A.K ka deklaruar se: Ne këtë çështje penale Prokurori i Shtetit ka ngritur aktakuzën me kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor kundër të pandehurit M.C, për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par. 2 të KPRK-së.

Gjykata, duke vepruar konform nenit 495 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe mbështetur ne kërkesën e Prokurorit të Shtetit për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe mbështetur ne provat ne shkresat e lëndës, kundër të pandehurit ka nxjerr aktgjykimin numër P.nr.3729/21 të dt.

03.03.2023, me të cilën e ka aprovuar kërkesën e Prokurorit të Shtetit për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të pandehurin e ka shpallur fajtor dhe e ka dënuar me dënim me gjobë.

Pas lëshimit të aktgjykimit nga gjyqtari i çështjes, aktgjykimi është tentuar ekspedimi te të gjitha palët në procedurë.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka ardhur në përfundim se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit A.K.

Në referim të pretendimeve të parashtruesit të ankesës si dhe bazuar në Ligjin për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, për Autoritetin Kompetent ishte e rëndësishme gjetja e shkeljeve të cilat parashihen me nenin 5 të Ligjit Nr. 06/L – 057, të cilat janë: dënimi për një vepër penale; shkelja e ligjit, ose shkelja e detyrave të tij zyrtare si gjyqtar.

Sa i përket pretendimit të paraqitur nga ankuesi se gjyqtari i çështjes nuk e ka ftuar në seance lidhur me çështjen por ka nxjerrë aktgjykimin me urdhër ndëshkimor P.nr. 3729/21 të datës 03.03.2023, Kryetarja e Gjykatës ka vlerësuar se veprimet e gjyqtarit gjatë trajtimit të lëndës gjyqësore, janë veprime të ndërmarra në kuadër të autorizimeve të tij si gjyqtar dhe si të tilla nuk mund të paraqiten si pretendime për shkelje disiplinore. Kjo për faktin se gjyqtari në aktgjykimin e lartcekur, ka arsyetuar bazën ligjore të dhënies së aktgjykimit, ku ndër të tjera në arsyetim të aktgjykimit, kishte theksuar se aktgjykimi ishte marrë në harmoni me nenin 493 dhe 495 të KPPRK-së.

Në lidhje me pretendimin se gjyqtari i çështjes ka bere shkelje dhe i kishte bere dëme te mëdha në këtë rast pasi që nuk e kishte ftuar në seancë, Kryetarja e Gjykatës ka vlerësuar se në rastin konkret gjyqtari i çështjes ka nxjerrë aktgjykimin me urdhër ndëshkimor në harmoni me dispozitat ligjore, ku me nenin 493 të KPRK-së parashihet se për veprat penale për të cilat parashihet dënim me gjobë ose burgim deri në tri (3) vjet paraparë në Kodin Penal, për të cilat prokurori i shtetit është informuar në bazë të provave të besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit mund të kërkojë në aktakuzë që gjykata të jep urdhër ndëshkimor, në të cilin të akuzuarit do t'i shqiptojë dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor. Andaj, në këtë konstatim, nuk konsiderohet se gjyqtari i çështjes ka bere shkelje apo i ka bere dëme palës se dëmtuar, pasi që konsiderohet se i njëjti aktgjykim është marrë në harmoni me KPPRK-në.

Në lidhje me faktin se i akuzuari M.C, ka dashur të vras dhe po i shkakton dëme dhe për këtë e mbështetet edhe një prokuror në Dragash, Kryetarja e Gjykatës konsideron se këto nuk janë pretendime ankimore të cilat e njëjta është kompetente për t'i shqyrtuar a po vendosur, kjo sepse në lidhje me këto pretendime palët duhet ti drejtohen organit të Prokurorisë së Shtetit.

Autoriteti kompetent vë në pah se nuk është paraqitur asnjë provë nga ana e parashtruesit të ankesës në cilësinë e të dëmtuarit E.B, qe provon se gjyqtari A.K ka kryer shkelje disiplinore të parapara me Ligjin Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ku në nenin 5 të këtij ligji janë paraparë në mënyrë decidive shkeljet disiplinore të gjyqtarëve, për të cilat Autoriteti Kompetent mund të inicoj procedurë disiplinore.

Nga të lartcekurat, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të

besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/22/24, me datë 08.10.2024

Albina Shabani Rama

---

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë